



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA DURRËS
KËSHILLI BASHKIAK

VENDIM

Nr.105, datë 30.10.2020

PËR

MIRATIMIN E PËRDORIMIT TË FONDIT 995.000 LEKË PËR SHËRBIMIN NË FAMILJE PËR FËMIJË ME AFTËSI TË KUFIZUARA TË MOSHËS 2-6 VJEÇ, TË CILIN BASHKIA E PËRFITON NGA PROGRAMI I PËRBASHKËT I KOMBEVE TË BASHKUARA “ASKUSH TË MOS MBETET PAS”, ZBATUAR NGA UNDP

Në zbatim të ligjit nr.139/2015 datë 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore” i ndryshuar, ligjit nr. 68/2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”, ligjit nr. 88/2019, datë 18.12.2019 ”Për buxhetin e vitit 2020”, ligjit nr.9936 datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, Ligjit nr.18/2017 “Për të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijëve”, ligjit nr.121/2016 “Për shërbimet e kujdesit shoqëror në Republikën e Shqipërisë”, VKB nr. 419, datë 03.04.2017 “Për miratimin e planit social dhe planit të përfshirjes sociale të Bashkisë Durrës”, Marrëveshjes së bashkëpunimit me UNDP nr. 12143 Prot, datë 02.10.2020, si dhe sipas relacionit të përgatitur nga Drejtoria e Shërbimit Social, me propozim të Zëvendëskryetares së Bashkisë, e cila kryen funksionet e Kryetares së Bashkisë,

KËSHILLI BASHKIAK
V E N D O S I :

1. Miratimin e shtesës me 2 punonjës (psikolog dhe punonjës social) pranë Qendrës së Shërbimeve Komunitare për Fëmijët me Aftësi të Kufizuara për një periudhë kohore prej 8 muajsh si më poshtë vijon:

Nr.	Emërtimi i Pozicionit	Numri i punonjësve	Klasa	Shtesa për pozicion
1.	Psikolog	1 (një)	III-B	44'330 Lekë
2.	Punonjëse sociale	1 (një)	III-B	44'330 Lekë

2. Miratimin e përdorimit të fondit prej 995'000 lekë, të akorduar nga UNDP për ofrimin e shërbimeve në familje për fëmijët me aftësi të kufizuar të moshës 2-6 vjeç, ndarë si mëposhtë vijon:
 - Paga e 2 punonjësve shtesë, (Artikulli 600) në vlerën 781.440 lekë.
 - Sigurime shoqërore dhe shëndetësore (Artikulli 601) në vlerën 98.560 lekë.
 - Shpenzime operative (Artikulli 602) në vlerën 115.000 lekë.
3. Veprimet financiare të kësaj qëndre do të kryhen nga nëpunësi zbatues i nivelit të dytë pranë Qendrës Ditore të Moshuarve.
4. Ngarkohet për zbatimin e këtij vendimi Drejtoria e Buxhetit, Drejtoria e Shërbimit Social dhe Drejtoria e Burimeve Njerëzore në Bashkinë Durrës.
5. Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë mbas shpalljes (sipas përcaktimeve të nenit 55, pika 6, të ligjit nr.139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, i ndryshuar).

KRYETARI KËSHILLIT BASHKIAK

Ani Dyrmishi



U shpall sot me datë 30.10.2020



BASHKIA DURRES
Dt: 04/11/20 Nr. 12925/6 PROT

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
PREFEKTI I QARKUT DURRËS

Nr. 992/prot.
4

Durrës, më 04/11/2020



Lënda: Verifikim i ligjshmërisë së aktit

KËSHILLIT BASHKIAK

DURRËS

Verifikova ligjshmërinë e Vendimit të Këshillit Bashkiak Durrës Nr.105 datë 30.10.2020 Për miratimin përdorimit të fondit 995 000 lekë për shërbimin në familje për fëmijë me aftësi të kufizuara të moshës 2-6 vjeç, të cilin bashkia e përfiton nga programi i përbashkët i Kombeve të Bashkuara “Askush mos të mbetet pas”, zbatuar nga UNDP.

E gjej atë të bazuar në ligj dhe në bazë të kompetencave që me jep Ligji Nr.107/2016 “Për Prefektin e Qarkut”, e konfirmoj bazueshmërinë ligjore të tij.

Duke ju falenderuar për bashkëpunimin.

PREFEKTI

ROLAND NASTO

